



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1802/3 Prot.

Tiranë, më 14.07 .2023

V E N D I M

Nr. 40, datë 14.07 2023

“PËR

MIRATIMIN E KONTROLLIT TË TESTIT FIZIKË SPECIFIKË PËR PËRBALLIMIN FIZIKISHT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT PËR STUDENTËT FITUES NË KONKURSET E PRANIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 38, të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në shkresën nr. 1308 prot, datë 11.05.2023 të Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit ”Propozim për listën e çmimeve për testet laboratorike” në Vendimin e Senatit Akademik nr.57 datë 26.05.2023 “Për miratimin e çmimeve refencë të listës së analizave dhe testeve që do të kryhen në laboratorët e Universitetit të Sporteve të Tiranës nga studentët e ciklit të dytë dhe të tretë”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 41 datë 29.05.2023 “Për miratimin e çmimeve refence të listës së analizave dhe testeve që do të kryhen në laboratorët e UST nga studentët e ciklit të dytë dhe të tretë” në Vendimin e Rektoratit nr.67 datë 10.07.2023, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 14.07.2023,

V E N D O S I:

1. Studentët fitues në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2023-2024 ti nënshtrohen kontrollit të testit fizikë specifikë për përballimin fizikisht të programit të studimit sipas tarifave përkatëse.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, FSHL, FVFR, IKSHS, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof Dr Agron KASA

